

PANAJOT ZOTO

LIANA

ROMAN

BOTIMET TOENA

PANAJOT ZOTO

LIANA

roman

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi

Redaktor: Eris Rusi

Korrektore letrare: Meri Toçi

Përkujdesja grafike: Gea Qëndro

ISBN

© AUTORI *dhe* BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", nr. 71, Tiranë 1023
ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Kjo ishte rruga e mbërritjes deri këtu, e filluar nga rrënjët, sepse nuk mund të mbërrihet në majë pa u nisur nga rrënjët. Rrënjët tona nuk mbajnë vetëm historinë, por dhe fuqinë krijuese.

KAPITULLI I

Atë pasdite punoi më shumë se zakonisht për t'i dhënë dorën e fundit librit. E ulur në tavolinën e punës ndiente lodhjen, por edhe një lloj kënaqësie gudulisëse. E shtyu karrigen më tej dhe u çua. Shtriqi krahët, siç bënte zakonisht pas pune për të çmpirë trupin, dhe iu afrua dritares. Hapi paksa perden dhe hodhi vështrimin tutje për të parë horizontin me ngjyrën alle të diellit në perëndim, aty ku qielli puthej me detin. Ishte ky një ritual i çdo buzëmbërëmjeje, kur ndodhte që vështrimi i saj të ndeshej edhe me dukuri të pazakonta, që shkaktoheshin nga mirazhe megjullore si kjo e sotmja. Tutje, dritat e rrugës, veshur nga një cipë e hollë megjulle, krijonin përreth llambave ndriçuese një lloj aureole të ngjyrshme, befasuese.

Ndenji për një kohë kështu, e përhumbar në mendime, me vështrimin mbërthyer mbi atë pamje mahnitëse, pastaj e uli perden dhe u kthye në tavolinën e punës. Me sytë e mendjes kërkonte të gjente fjalët për frazën përmbyllëse të romanit, me vogëlushen Anna në epiqendër të tij. Anna, vajza që shiste lule për të ushqyer veten dhe prindërit e sëmurë, ishte njëra nga vogëlushet që

kishin gjetur ndihmë e strehë te kjo shtëpi dhe te kjo grua bamirëse, që ia kushtoi jetën mirësive, duke ndihmuar të pamundurit. Ngjallte ndër ta optimizëm dhe u mëkonte, si nëna fëmijëve të vet, dashurinë për jetën.

U përkul mbi tastierë dhe gjithçka kishte akumuluar në aparatin krijues të mendimit e zbrazti, duke formuluar frazën: “Kjo është historia. Dhe kur historia mbaron lë pas shumë ndjenja dhe dashuri. Koha tregoi se kushdo mund t’ia dalë, dhe se dielli sërish lind, sado e errët të jetë nata”. Lëshoi pastaj një pasthirmë të ëmbël si një puhi pranverore, duke shpërfaqur kësisoj një lloj kënaqësie, si e dalë nga fundi i shpirtit. E dinte se puna nuk mbaronte këtu, por kjo nuk e ligështonte. Do të vinte koha e botimit. Në mendje planifikonte gjithë rrugëtimin e produktit brenda kompjuterit, deri te lexuesi.

* * *

Në dyqanin e veshjeve, ku punonte, e vlerësonin shumë. Shoqet e inkurajonin dhe i thoshin se ishte një grua e plotësuar. Ndonëse në një moshë kur gratë kërkojnë të sillen si të reja dhe t’i fshehin rrudhat në lëkurë, ajo, në sytë e të tjerëve, mbetej një grua rrëzëlluese, mendjehapur, moderne...

Mbylli me kujdes derën e dhomës ku ishte tavolina e punës, përballë një rafti të mbushur me

libra dhe zbriti shkallët e drunjtë, që të çonin në korridorin e katit të dytë ku ishte salloni i pritjes dhe dhomat e gjumit. Vila trekatëshe, nga më të vjetrat në atë zonë të bregdetit të Athinës, bënte dallim nga shtëpitë që rrethonin tre anët e saj. Një ballkon i gjatë prej druri i mbuluar me strehë dhe i mbështetur mbi shtylla druri përdorej dikur si vend çlodhjeje, ku miqtë e zonjës së shtëpisë kalonin orë të tëra duke biseduar e luajtur poker. Një oborr katror poshtë tij, që përfundonte me një mur dhe portën metalike. Ballkoni shtrihej gjatë tri faqeve të fasadës së brendshme, me dy kthesa gati kënddrejta të formuara në qoshet anësore të vilës. Në katin e poshtëm ishte galeria dhe një sallë e vogël, që përkonte me një ballkon të stilit *beletazh*, ndërsa poshtë, pas avllisë, një kuzhinë verore ngjitur me kopshtin e trëndafilave, për të cilin ajo kujdesej me dashurinë e një kopshtari profesionist. Zonja e shtëpisë donte ta shihte atë të mbushur me lule shumëngjyrëshe dhe të thithte mëngjeseve erëmirën e trëndafilave.

Kur kishte hyrë në këtë mjedis, enigmatik për të, në fillim të viteve '90-të, zonja e shtëpisë, që ishte një aktore e dashur për athinasit, veç porosive dhe kërkesave të tjera për shërbim ndaj saj, i kishte thënë se duhet të punonte edhe në kopshtin pas shtëpisë që ishte gati në degradim për shkak të pamundësisë së saj për t'u shërbyer bimëve, që i jepnin dikur atij mjedisi bukurinë e

ngjyrave të luleve që kultivoheshin në të. “Me një trëndafil zë një miqësi. Është lulja që i dhurohet më shpesh njerëzve, - thoshte ajo dhe shtonte me një gjestikulacion aktori dhe zëshëm:

- Trëndafili është imazhi i bukurisë dhe i dashurisë”.

Atë mbrëmje nuk vuri gjë në gojë. Edhe pse ishte herët për të rënë në shtrat, ajo u fut në dhomën e gjumit. U ul në karrige, një lloj *shezlongu* të thurur me fije kashte, dhe mori në tavolinën aty pranë librin me poezi të Rudyard Kipling. Hoqi fijen e letrës treguese në faqen ku e kishte lënë leximin dhe, me një zë të brendshëm, nisi të deklamonte poezinë që i bën jehonë jetës. E kishte mësuar thuajse përmendësh:

*“Nëse, kur bota ndalet përballë teje
Dhe frika të bren shpirtin pa mëshirë,
E ti qëndron me kokën lart për çdo thërrmijë,
I pathyer në çdo përplasje, e ende më i mirë...”*

Ka qenë kjo poezia e preferuar e zonjës së shtëpisë, që edhe pse në karrierën e gjatë si aktore kishte lëçitur e interpretuar dhjetëra poezi e monologë kushtuar dashurisë për jetën, poezinë e Kipling e përsëriste vijimisht sa herë mbledheshin dhe aktronin, në këtë vilë, kolege e kolegë, aktorë të zëshëm të Athinës, ku arti dhe letërsia janë si gjaku që rrjedh në vena. Poshtë

këtij kati, në sallën e teatrit, mblihdeshin miq e shokë moshatarë, por edhe djem e vajza të reja që sapo kishin nisur karrierën. Zonja i ndihmonte ata, u mësonte sekretet e aktrimit dhe, ndodhte që bëheshin, në atë skenë të vogël, edhe prova të dramave të ndryshme, që më pas luheshin në sallat teatrore të kryeqytetit grek. Në këtë vilë i bënë shoqëri zonjës së shtëpisë aktorë e aktore të njohur si Varkulis, Kostidu, Argeropolios, Constandine etj. Më shumë se dy dekada më parë vinte në këtë vilë edhe aktorja M.M. nga Shqipëria, që kishte emigruar pas një divorci të dhimbshëm dhe nevojës për të qëndruar larg mjediseve ku thashethemet dhe përgojimet e tmerronin dhe ia bënë jetën të pajetueshme. Zonja sillej me të si nëna me vajzën e saj. Kur ajo i kishte thënë një ditë se emri Pirhiani ngjasonte me emrat që vijnë thellë nga lashtësia, zonja kishte tundur kokën. “Po, - i pat dhënë përgjigje, - rrënjët e mia janë thellë në lashtësi. Stërstërgjyshja ime quhej Pirha, emër ky që vjen nga emri Pirrhes, i trashëguar brez pas brezi dhe që është, sipas legjendës mbizotëruese, gruaja e Deukalionit, me të cilin ka lindur Helenin, që u bë më vonë themeluesi i Helenëve... Ja, shiko këtu”, - kishte vijuar pasi kishte nxjerrë nga sirtari i skrivanisë, poshtë një pasqyre të gjatë, dy albume me fotografi dhe shënime. Nisi të shfletonte fletë pas flete, duke treguar historinë e të parëve të saj përmes fotografive të shumta që mbanin albumet...

Kujtonte Liana këto momente të jetës në këtë vilë, kur historitë e shumta që tregonte aktorja-plakë shtynin orët e gjata të netëve dimrit. Ishte aktore e madhe dhe njeri i thjeshtë që nuk i pëlqenin lëvdatat. Shpesh përmendte thënien e Sokratit: “Jeto pa u dukur”, dhe shtonte pas saj: “Të tjerët janë ata që do shpërfaqin madhështinë e jetës tënde”. Fliste me nostalgji për karrierën ndër vite, për të cilën thoshte: “Është shoqja ime më e mirë”. Pinte gjithnjë nga pak *Manhatan*, një lloj pijeje me gjethe trëndafili. Për Lianën, ajo ishte një engjëll dhe shpesh thoshte: “Edhe se engjëjt jetojnë në qiell, ajo ishte e tillë këtu në tokë”. Ishte njeriu më shpirtmirë që kishte njohur në jetë.

Vilën trekatëshe, me kopshtin e trëndafilave dhe sallën e vogël të provave, që ngjante më shumë me një plate kishe, ku skena e vogël shëmbëllente me jeronë ku shërben prifti, zonja e shtëpisë e kishte trashëguar nga i ati, një tregtar i madh, zotërues i disa pronave në periferinë e Glifadhës. Burri i saj, një ushtarak madhor, u nda nga kjo botë para se ajo të dilte në pension. Kishte mbetur pa njeri në fund të viteve ‘80-të të shekullit të kaluar, kur djali i vetëm i saj, Andreas, vdiq në një aksident automobilistik në një zonë në veri të Kanadasë, rrugës për të shkuar në punë. Kishte marrë drejtimin e punëve në minierën e diamantit në atë zonë, pasi xhaxhai i tij, që e zotëronte, ishte

në moshë të thyer dhe në pamundësi administrimi të punëve...

Liana e kishte mbushur këtë boshllëk familjar, u bë për të më shumë se një vajzë.

Kishin kaluar vite, shumë vite, nga ajo ditë që kishte trokitur në portën e hekurt të kësaj vile. Zonja, e veshur me një fustan të gjatë të kombinuar me shallin që e kishte në ngjyrën e syve të saj, si deti, kishte zbritur dhe kur pa dy gra, pas asaj porte metalike, i kishte pyetur se ç'dëshironin. Njëra prej tyre i tha se gruaja në krahë të saj kishte muaj që e kërkonte këtë shtëpi, por...

- Ti?! – u habiti zonja. - Gruaja që...

- Po, është shqiptarja që do të punonte te ju.

E habitur, me një buzëqeshje që nxirrte në pah hilet femërore edhe pse mosha kishte lënë gjurmë në fytyrën simpatike të saj, zonja e kishte përqaftuar, pastaj, të kapura për dore, lëvizën drejt hyrjes së asaj godine me një arkitekturë befasuese për Dianën. Në katin e dytë të vilës zonja e mirëseerdhi dhe i tha se kishte muaj që e priste.

- Ku ishte? - e pyeti me kureshtje të pafshehur, teksa e kishte aty, para syve, njeriun që e dinin të humbur. Diana e falënderoi për pritjen dhe i shpjegoi gjithçka. I tha se kishte dalë nga errësira e ferrit dhe fati e deshi të mbërrinte këtu, në këtë shtëpi, ku ishte nisur për të ardhur muaj më parë. Biseduan gjer vonë në pasditen e asaj dite fatlume

për Dianën. Zonja i tregoi për peripecitë e shumta dhe përpjekjet e bashkëshortit të saj për ta gjetur. Nxitoi pastaj t'i telefononte nipit në Korfuz. “Tani do bëhemi familje e madhe”, i buzëqeshi, po Diana, që e kuptoi dëshirën e saj, i tha se Albani, do të qëndronte në ishull edhe për ca kohë. Do të përpiquej të rregullonte dokumentet dhe të shkonte në Shqipëri të merrte vajzën e vogël, që e kishin lënë atje.

- Keni një vajzë dhe e keni braktisur? Si mund të lihet vetëm një fëmijë?! - gati kishte thirrur zonja. Dianën e stepi ky reagim qortues i zonjës, për atë që ajo e quajti “indiferencë prindërore”. Si t’ia shpjegonte? Edhe gjuhën nuk e dinte mirë.

Tha se kishin kaluar jetë të vështirë dhe për këtë e lanë vendin. “Nuk mund ta merrnim me vete vajzën në rrugëtimin mes maleve dhe pa siguruar një strehë dhe punë”, - iu hap. I tregoi për ftesën e mbërritur nga fshati matanë kufirit dhe për vajtjen atje me një leje nga autoritetet vendore. I foli për vendimin për të mos u kthyer mbrapsht dhe ndihmën që u kishin dhënë banorët e fshatit kufitar për të shkuar në Korfuz. “Ishte një rastësi e bukur kur atje na pritni njeriu që më pas na lidhi me ju”, - e përmbylli ajo.

Në bisedë me zonjën e vilës, ajo përdorte një greqishte të çalë, me fjalë që bashkoheshin herëherës pa kuptim për të formuluar një fjali me të

cilën të ushqente bisedën. Kur zonja e shtëpisë e kishte pyetur për emrin ajo i kishte thënë se quhej Diana, por në qytetin e lindjes i flisnin shkurt Anna. “Diana Gjoni, është emri dhe mbiemri im”- i shpjegoi dhe pa se si zonja kishte rrudhur buzët në heshtje, me një vështrim ngulitës te një fotografi në faqen e murit përballë, duke nëpërdhëmbur, jo pa vështirësi: “Diana... Diana... Gjoni”. Pastaj, si të kishte gjetur atë që kërkonte, kishte thirrur: “Liana Sionis... Liana Sionis... Më mirë kështu, ë?! Këtu, në Greqi, është vështirë të shqiptohen gjerat ‘D’ dhe ‘Gj’... Si të duket Liana Sionis?... Me këto gjenealitetet do të bëjmë edhe dokumentet e leje qëndrimit dhe...”. Zonja e shtëpisë e kishte kapur përdore, e kishte afruar pas vetes dhe i kishte pëshpëritur në vesh disa fjalë që banores së re të vilës i kishin mbetur në mendje. “Vetmia ime kaq zgjati, tani jemi bashkë”. Pastaj e kishte përqaftuar duke i thënë: “Dua të bëj më të mirën për ty, që ta harrosh fatkeqësinë dhe tragjedinë jetësore. Kam njohur dhe përjetuar edhe unë dhimbjen, kam bashkëjetuar me të, si dhe me gëzimet që jeta më ka ofruar. Je e bukur dhe ke një hijeshi të rrallë me buzëqeshjen tënde. Do kalojmë mirë bashkë sa të kem jetë, por dije se do të të fal shpresën...”.

Vitet kaluan shpejt dhe Diana, nga lartësitë e tyre shikonte ndryshimin. Për të, jeta nuk kishte

kuptim pa një punë të dobishme për shoqërinë, pa ndihmuar njerëzit në nevojë. Pa u marrë me një punë, qoftë dhe me përkujdesjen për kopshtin, amanetin e lënë nga zonja e vilës. Jeta për të s'kishte kuptim pa lexuar letërsi, nga ku, si thoshte zonja, burojnë dijet dhe kultura. E kishte të fiksuar në kujtesë thënien, dikur të lexuar, se: “Të jetosh nuk do të thotë të marrësh frymë. Të jetosh do të thotë t’u japësh ditëve dhe viteve kuptim”... E mori sërish në dorë librin me poezi të Rudyard Kipling dhe vijoi leximin atje ku e kishte lënë:

*“Nëse ti ruan paqen në një botë të egër,
Ku frika dhe urrejtja s’kanë vend të qëndrojnë,
E ndërton nga hiri të ardhmen e shpirtit tënd,
Dhe i reziston humbjes pa u dorëzuar përballë
saj...”*

Po afronte mesnata dhe Liana nuk kishte shkuar ende në shtrat. Në kafazin e mendjes i përziheshin fjalët, shprehjet, paragrafët... e gjithë përmbajtja e librit të sapopërfunduar. “Eh, si qenka jeta! -thoshte me vete. - Nuk është njësoj. Lëviz gjithnjë. E djeshmja nuk i ngjan të sotmes”. E djeshmja e saj i ngjante një beteje për ekzistencë. Kërkonte të shihte pak dritë dhe ishte zotuar se nuk do ta lejonte veten të binte në errësirë. Tani thuajse kishte gjithçka, por jo

ato më të shtrenjtat. I mungonte vatra ku kishte lindur. Atje e kishte lënë një copë të zemrës. I mungonin shokët e fëmijërisë dhe bukuria e viteve rinore. I mungonte qyteti që kishte lënë. I mungonte familja. Emigracioni nuk është i lehtë. Këtë e kuptonte, e ndiente si dhimbje nën lëkurë. Megjithatë, përpiquej t'i largohej së shkuarës, të mos jetonte përditë me të. Sa herë Liana binte në mendime dhe kujtonte me nostalgji kohën e shkuar, zonja e shtëpisë i thoshte: “Sa më shpejt ta lësh të shkuarën, aq më shpejt do shkosh përpara”.

E la librin me poezi mbi tavolinë dhe iu drejtua shtratit. Hoqi fustanin që mbante gjatë ditës në shtëpi dhe ndenji për pak, kështu, gjysmë e zhveshur përballë pasqyrës. Nuk ishte më ajo e para, megjithatë e ruante freskinë dhe dukej se e kishte një hijeshi naive. Kujtimet përkalleshin brenda saj dhe ajo shihte me sytë e mendjes brishtësinë e një trupi të lodhur nga vitet. I dukej vetja si toka e kthyer nga plugu, shumë e ndryshme nga dikur. Vetëtimthi shkoi nëpër mend thënie: “Është mëkat që gratë të gjykohen nga pamja”, lexuar diku nëpër librat e shumtë që mbushnin raftet e bibliotekës të asaj vile. La fustanin në gardërobën aty pranë, veshi nxitimthi një këmishë nate në ngjyrën e trëndafilit të verdhë dhe u shtri. Gjumi e zuri vonë, afër mëngjesit. Sa herë i largohej gjumi, si kësaj nate, e shihte veten zgjuar në ëndrrat e të dashurve të saj.

KAPITULLI II

Ajo banonte në një ndërtesë nga më të vjetrat, në qendër të qytetit, në një dhomë të katit të dytë. Korridorin e ndante me fqinjët. Po ashtu edhe banjën. Hynte e dilte nga banesa gati pa u ndjerë dhe, kur ndodhte të shkëmbehej në korridor me fqinjët, i përshëndeste e qeshur, duke shpërfaqur mirësinë dhe dëlirësinë e shpirtit. Nga sytë e saj dukej se dilte një dritë flakëruese. Albani, bashkëshorti, një djalë i bëshëm, me një ecje flegmatike dhe fjalëpak, ishte tip i mbyllur në vetvete dhe, për këtë, shokët e thërrisnin “mizantropi”. Dilte herët në mëngjes nga shtëpia dhe mbrëmjeve kthehej vonë. Komanda e repartit ushtarak ku ai shërbente, ndodhej në qytetin fqinj.

Çifti Gjoni bënte një jetë bashkëshortore të mbyllur dhe gati të padukshme. Ekonomikisht... jo si shumica e familjeve të atij qyteti, ku varfëria kishte fytyrën e vetë sistemit, me paaftësinë për t'u garantuar strehim dhe mirëqenie qytetarëve të vet. Prindërit e Dianës kishin bërë përpjekje të mëdha për ta punësuar vajzën, pas mbarimit të shkollës së mesme, në ndërmarrjen e prodhimit të veshjeve, edhe pse vetë Diana nuk dëshironte.

Ajo donte të vazhdonte studimet. I pëlqente letërsia dhe u lutej prindërve ta lejonin të shkonte në universitet. Por ja që do të vinte momenti, ajo mbrëmje, kur bota e ëndrrave të saj do të shkërmoqej, copëzohej, si copat e kristalta të një gote kur thyhet e s'ngjitet më.

* * *

... Atë natë, xha Sefua, babai i saj, me një zë gërvishtës, shenjë kjo e një sëmundjeje që prej vitesh e mundonte, do t'ia priste shkurt, duke i thënë se nuk kishte më kohë “për të tjera shkolla”. Kjo thënie ia kishte ndezur vajzës flakën e zemërimit dhe me një zë gati bërtitës i ishte përgjigjur paralajmërimit të të atit:

- Po pse...! Unë dua të shkoj në shkollë! Dua...

- Do shkosh në punë dhe pikë! I jam bërë urë sekretarit të partisë për atë vend pune, kupton?

- Po mua nuk më pyete. Pse, pse o ba... unë...

Ai, nuk e la të shpjegohej. Bablok në dukje, por që nuk bënte kompromis me parimet e tij zakonore, kishte ngritur tonin dhe pas tij s'guxoi kush të nxirrte zë. Në atë dhomë pllakosi heshtja e rëndë. Diana, e vrarë në shpirt, e pezmatuar, doli me vërtik nga dhoma duke fshehur, me pëllëmbët e duarve, sytë e skuqur nga mospërfillja. Ndriçimi i syve iu venit dhe nënkataraktet e llagartë të tyre iu qullën nga pika loti të ngrohtë.

- Po ç'bëre a ditëzi, ç'bëre! Të vejë vajza në shkollë se ka avenirin e vet. E di që jemi hollë dhe rroga e saj na duhet, por do bëjmë si do bëjmë...

- Kështu thua ti?! - iu kthye gruas ai me një ton si prerje sëpate. - Po muhabetin që kemi bërë me miqtë?

- E di, po, mbase...

- Nuk ka mbase. Vajza do të vejë në punë dhe me kohë do t'ia themi. Vajza të do bindet se ne të mirën ia duam.

Këtu ishte mbyllur biseda. Halimeja kishte dalë kokulur nga ajo dhomë e mbushur me tym duhani që dilte shtëllunga-shtëllunga nga çibuku i xha Sefos, dhe shkoi pranë vajzës që dëneste mbi krevat.

* * *

... Vitet kishin kaluar duke mbartur ditë pas dite brengat e shpirtit të saj. E ulur pranë krevatit metalik mbuluar me një çarçaf të hollë qëndisur te cepat me një dantellë ngjyrë vjollce, i këndonte vajzës së vogël ninulla për ta vënë në gjumë. U martua tri vite më parë me Albanin dhe u bë nënë në një moshë kur, siç thoshte shpesh në momente që e kaplonte mërzitja dhe qante së brendshmi, duhet të ishte në universitet, të bënte jetën që kishte ëndërruar.